

**AKT THEMELIMI  
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
YMALKO ALBANIA SH.P.K**



Sot, më 24.04.2019, u paraqit pala e mëposhtme:

- **YMALKO Sh.p.k**, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar dhe që vepron sipas legjislacionit të Republikës së Kosovës, me seli në Rr. Sejdi Kryeziu, nr. 38, kati 1, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës, e regjistruar me numër biznesi 810031451, ligjërisht e përfaqësuar nga z. Samir Krasniqi, shtetas i Republikës së Kosovës, lindur në Pomozotin, Republika e Kosovës, më 06.02.1972, me lëtërnjoftim nr. ID0283167 e nr. personal 2014313977, i autorizuar me vendimin e shoqërisë në fjalë, datë 15.04.2019.

Pala e mësipërme ka vendosur të hartojë këtë Akt Themelimi të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar (në vijim referuar si "Shoqëria"), veprimtaria e të cilës do të rregullohet nga legjislacioni shqiptar në fuqi dhe Statuti, i cili i bashkëlidhet si Shtojca 1 dhe që përbën një pjesë thelbësore të këtij Akt Themelimi.

**Neni 1 - Emërtimi i Shoqërisë**

Është themeluar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e quajtur YMALKO Albania Sh.p.k.

**Neni 2 - Selia**

Selia e Shoqërisë është në adresën: Blvd. "Dëshmorët e Kombit", Twin Towers , Tower 2, kati 7, Tiranë, Shqipëri.

**Neni 3 - Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë me një afat të pacaktuar.

**Neni 4 – Objekti**

- 4.1 Shoqëria do të ketë për objekt: tregtimin me shumicë dhe/ose pakicë, shitjen, blerjen e produkteve dhe materialeve të ndryshme, në veçanti të materialeve dhe produkteve të drurit dhe ato që përdoren në fushën e ndërtimit (përfshirë edhe pajisje hidrosanitare dhe aksesore që lidhen me to); zhvillimin e projekteve të ndërtimit; ndërtimin e objekteve të ndryshme pa asnjë kufizim, si psh ato civile, industriale, ushtarake, etj.; punime hidraulike, instalime të sistemeve të ngrohjes, ftohjes e kondicionimit; instalime elektrike dhe instalime të tjera ndërtimore; aktivitetin e ndërmjetësimit, përfshirë edhe ato që lidhen me shitjen e blerjen e materialeve të ndërtimit dhe lëndës së drurit; transportin e mallrave dhe aktivitete të tjera që lidhen me transportin; ofrimin e shërbimeve të arkitekturës, inxhinjerisë, këshillimit teknik e konsulencë në fushën e ndërtimit; shkëmbimin, blerjen, shitjen, dhënien me qira, menaxhimin, administrimin e pasurive të paluajtshme dhe të luajtshme, si dhe zhvillimin e të gjitha aktiviteteve të lidhura direkt ose indirekt me aktivitetin e ndërtimit; si edhe kryerjen e çdo lloj aktiviteti tjetër që nuk është i ndaluar me ligj.
- 4.2. Përveç kësaj, në përputhje me legjislacionin shqiptar, Shoqëria mund të kryejë çdo transaksion që lidhet me pasuritë e luajtshme ose të paluajtshme, si dhe çdo aktivitet tjetër, si dhe çdo veprimtari tjetër që lidhet drejtpërdrejt ose tërthorazi me objektin e sipërpërmendur, ose që mund të konsiderohet i nevojshëm ose i dobishëm ose ndihmës për qëllimet e mësipërme, siç do të përcaktohet nga Shoqëria në diskrecionin e saj.

*Handwritten signature or mark.*

### Neni 5 – Kapitali themeltar

- 5.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë është ALL 500.000 (pesëqind mijë lekë).
- 5.2 Kapitali përbërë nga 1 (një) kuotë, plotësisht e nënskruar nga ortaku i vetëm i Shoqërisë.

### Neni 6 – Kontributet

Kontributet në kapitalin themeltar të Shoqërisë janë si më poshtë:

- **YMALKO Sh.p.k**, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar dhe që vepron sipas legjislacionit të Republikës së Kosovës, me seli në Rr. Sejdi Kryeziu, nr. 38, kati 1, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës, e regjistruar me numër biznesi 810031451, zotëron një kuotë në vlerën ALL 500.000 (pesëqind mijë lekë), e cila përfaqëson 100% (njëqind përqind) të kapitalit të Shoqërisë.

### Neni 7 – Transferimi i kuotave

Kuotat e Shoqërisë mund të transferohen tek palët e treta në përputhje me procedurat e përcaktuara në Statut.

### Neni 8 – Administrimi

- 8.1 Me anë të këtij akti, emërohet si Administrator i Shoqërisë personi si më poshtë:
- (i) z. Samir Krasniqi, shtetas i Republikës së Kosovës, lindur në Pomozotin, Republika e Kosovës, më 06.02.1972, me lëternjofitim nr. ID0283167 e nr. personal 2014313977.
- 8.2 Administratori i mësipërm emërohet për një hohëzgjatje 5 (pesë) vjeçare.
- 8.3 Administratori do të veprojë në përputhje me dispozitat e nenit 95 të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, Statutin dhe / ose aktin e emërimit.

### Neni 9 – Gjuha

Ky Akt Themelimi është hartuar në 3 (tre) kopje në gjuhën në gjuhën shqipe.

ORTAKU I VETËM

Për: **YLMAKO Sh.p.k**

SAMIR KRASNIQI  
z. Samir Krasniqi



**STATUTI**  
**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**YMALKO ALBANIA SH.P.K**

**KAPITULLI I**  
**EMËRTIMI, SELIA, KOHËZGJATJA DHE OBJEKTI**

**Neni 1 – Emërtimi i Shoqërisë**

- 1.1 Është themeluar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e quajtur YMALKO Albania Sh.p.k (këtej e tutje referuar edhe si “Shoqëria”).
- 1.2 Shoqëria ka vulën dhe logon e saj zyrtare.

**Neni 2 - Selia**

- 2.1 Selia e Shoqërisë është në adresën: Blvd. "Dëshmorët e Kombit", Twin Towers , Tower 2, kati 7, Tiranë, Shqipëri.
- 2.1 Shoqëria mund të hapë dhe/apo mbyllë degë, filiale dhe/ose zyra përfaqësimi, në Shqipëri dhe/apo jashtë saj, vendosur nga Mbledhja e Përgjithshme e Ortakëve.

**Neni 3 - Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë me një afat të pacaktuar.

**Neni 4 – Objekti**

- 4.1 Shoqëria do të ketë për objekt: tregtimin me shumicë dhe/ose pakicë, shitjen, blerjen e produkteve dhe materialeve të ndryshme, në veçanti të materialeve dhe produkteve të drurit dhe ato që përdoren në fushën e ndërtimit (përfshirë edhe pajisje hidrosanitare dhe aksesore që lidhen me to); zhvillimin e projekteve të ndërtimit; ndërtimin e objekteve të ndryshme pa asnjë kufizim, si psh ato civile, industriale, ushtarake, etj.; punime hidraulike, instalime të sistemeve të ngrohjes, ftohjes e kondicionimit; instalime elektrike dhe instalime të tjera ndërtimore; aktivitetin e ndërmjetësimit, përfshirë edhe ato që lidhen me shitjen e blerjen e materialeve të ndërtimit dhe lëndës së drurit; transportin e mallrave dhe aktivitete të tjera që lidhen me transportin; ofrimin e shërbimeve të arkitekturës, inxhinjerisë, këshillimit teknik e konsulencë në fushën e ndërtimit; shkëmbimin, blerjen, shitjen, dhënie me qira, menaxhimin, administrimin e pasurive të paluajtshme dhe të luajtshme, si dhe zhvillimin e të gjitha aktiviteteve të lidhura direkt ose indirekt me aktivitetin e ndërtimit; si edhe kryerjen e çdo lloj aktiviteti tjetër që nuk është i ndaluar me ligj.
- 4.2. Përveç kësaj, në përputhje me legjislacionin shqiptar, Shoqëria mund të kryejë çdo transaksion që lidhet me pasuritë e luajtshme ose të paluajtshme, si dhe çdo aktivitet tjetër, si dhe çdo veprimtari tjetër që lidhet drejtpërdrejt ose tërthorazi me objektin e sipërpërmendur, ose që mund të konsiderohet i nevojshëm ose i dobishëm ose ndihmës për qëllimet e mësipërme, siç do të përcaktohet nga Shoqëria në diskrecionin e saj.

**KAPITULLI II**  
**KAPITALI THEMELTAR, RITJA DHE ZVOGËLIMI I KAPITALIT DHE**  
**TRANSFERIMI I KUOTAVE**

## Neni 5 – Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i Shoqërisë është ALL 500.000 (pesëqind mijë lekë), i përbërë nga 1 (një kuotë). Kapitali themeltar i Shoqërisë është nënshkruar plotësisht si më poshtë vijon:

- **YMALKO Sh.p.k**, një shoqëri me përgjegjesi të kufizuar, e themeluar dhe që vepron sipas legjislacionit të Republikës së Kosovës, me seli në Rr. Sejdi Kryeziu, nr. 38, kati 1, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës, e regjistruar me numër biznesi 810031451, zotëron një kuotë në vlerën ALL 500.000 (pesëqind mijë lekë), e cila përfaqëson 100% (njëqind përqind) të kapitalit të Shoqërisë.

## Neni 6 – Rritja e kapitalit themeltar

- 6.1 Kapitali themeltar mund të rritet pa kufi në çdo moment, një ose disa herë, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.
- 6.2 Në rast rritjeje të kapitalit, të gjithë ortakët kanë të drejtën të nënshkruajnë rritjen në raport me kuotën e zotëruar prej tyre në kapitalin e shoqërisë. Në rast se ndonjë nga ortakët nuk e ushtrojnë këtë të drejtë, pjesët e tyre mund të nënshkruhen nga ortak/ët e tjerë proporcionalisht me kuotën e zotëruar prej tyre në kapitalin e Shoqërisë.
- 6.3 Nëse Asambleja e Përgjithshme miraton një vendim për rritje të kapitalit të Shoqërisë, Administratori/ët e Shoqërisë duhet të njoftojnë me shkrim çdo ortak ("Njoftimi i të Drejtave"). Njoftimi i të Drejtave, në përputhje me të dhënat e rritjes së kapitalit të Shoqërisë të përcaktuar në vendimin e sipërpërmendur, do të specifikojë: (1) vlerën totale shtesë të kapitalit që do të rritet; (ii) të drejtat, privilegjet, afatet dhe kushtet e rritjes së ofruar; dhe (iii) shumën e pagueshme për këtë rritje. Çdo ortak do të ketë të drejtën, e cila mund të ushtrohet brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga marrja e Njoftimit të të Drejtave, për të nënshkruar rritjen e kapitalit të përcaktuar në Njoftimin e të Drejtave në mënyrë të parevokueshme dhe në proporcion me kuotën e zotëruar në kapitalin themeltar. Nëse ndonjë ortak zgjedh të mos nënshkruajë ose të paguajë pjesën e tij në rritjen e kapitalit themeltar sipas specifikimeve të përcaktuara në Njoftimin e të Drejtave, atëherë ai ortak do të konsiderohet se ka hequr dorë në mënyrë të parevokueshme nga e drejta për nënshkrimin e pjesës së tij në rritjen e kapitalit, dhe ortakët e tjerë do të kenë të drejtën të nënshkruajnë dhe të paguajnë këtë pjesë të rritjes së kapitalit themeltar në proporcion me kuotën e zotëruar, brenda dhe jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga njoftimi i dërguar nga Administratori/ët e Shoqërisë tek këta ortakë.

## Neni 7 – Zvogëlimi i kapitalit themeltar

- 7.1 Shoqëria mund të zvogëlojë kapitalin themeltar me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme. Në çdo rast kapitali themeltar nuk mund të zvogëlohet nën kufirin e parashikuar nga ligji.
- 7.2 Zvogëlimi i kapitalit përballohet nga secili prej ortakëve në të njëjtën masë me kuotën e zotëruar prej tyre në kapitalin e Shoqërisë.

## Neni 8 – Transferimi i kuotave

- 8.1 Kuotat janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve.
- 8.2 Transferimi i kuotave të Shoqërisë në kuptimin më të gjerë të fjalës, me apo pa shpërblim, duke përfshirë këtu edhe dhurimin në favor të të tretëve, i nënshtrohet të drejtës së parablerjes siç është përcaktuar më mirë në vijim.

- 8.3 Në rast se ortakut i Shoqërisë ("Ofertuesi") dëshiron të transferojë, një pjesë ose të gjithë kuotën e zotëruar prej tij, duhet të kërkojë dhe të marrë një ofertë të shkruar në mirëbesim nga pala e tretë ("Përfituesi i Propozuar") për të blerë një pjesë ose të gjithë kuotën e Ofertuesit. Ofertuesi do të ofrojë fillimisht kuotën që dëshiron të transferojë tek ortakut tjetër, sipas rastit ("Përfituesi") me të njëjtat afate dhe kushte sipas ofertës së Përfituesit të Propozuar. Ofertuesi duhet të njoftojë Përfituesin ("Njoftimi i Ofertës") duke i komunikuar (i) kuotën që do të ofrohet ("Kuota e Ofruar"); (ii) identitetin dhe adresën e Përfituesit të Propozuar (iii) afatet dhe kushtet e shitjes së ofruar në ofertën e Përfituesit të Propozuar duke përfshirë edhe çmimin; (iv) datën në të cilën Përfituesi i Propozuar duhet të pranojë ofertën, datë e cila duhet të jetë jo më pak se 45 (dyzetë e pesë) ditë nga data në Njoftimin e Ofertës ("Data e Pranimit"); dhe (v) datën e fundit për blerjen e kuotës, datë e cila duhet të jetë jo më pak se 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga data e Njoftimit të Ofertës. Ofertuesi do të bashkëlidhë kopje të ofertës me shkrim marrë nga Përfituesi i Propozuar.
- 8.4 Përfituesi do të ketë të drejtën paraprake të blerjes dhe opsionin për të blerë Kuotën e Ofruar duke dorëzuar një njoftim pranimit të përvokueshëm ("Njoftimi i Pranimit") tek Ofertuesi në datën apo para Datës së Pranimit. Mbyllja e blerjes dhe shitjes do të zhvillohet në datën e përcaktuar në Njoftimin e Ofertës.
- 8.5 Nëse ndodh ndonjë nga ngjarjet e mëposhtme:
- (i) Përfituesi nuk e pranon Njoftimin e Ofertës ose Ofertuesi nuk ka marrë një Njoftim Pranimit brenda Datës së Pranimit;
  - (ii) pas lëshimit të Njoftimit të Pranimit, Përfituesi nuk arrin të blejë dhe paguajë për Kuotën e Ofruar në datën dhe vendin e specifikuar në Njoftimin e Ofertës për çfarëdo arsye jo për shkak të fajit të Ofertuesit;
- atëherë Ofertuesi do të jetë i lirë të shesë Kuotën e Ofruar tek Përfituesi i Propozuar sipas afateve dhe kushteve të ofertës fillestare të Përfituesit të Propozuar për një periudhë prej 120 (njëqind e njëzet) ditë nga Data e Pranimit, me kusht që Ofertuesi të sigurojë që Përfituesi i Propozuar të bie dakord me shkrim se do të jetë i detyruar të respektojë të gjitha termat dhe kushtet e këtij Statuti dhe marrëveshjes së ortakëve (nëse ka) si të ishte palë në to që nga fillimi. Në rast se Ofertuesi nuk është në gjendje të përfundojë shitjen tek Përfituesi i Propozuar brenda një periudhe të tillë prej 120 (njëqind e njëzet) ditësh, shitja e çdo kuote do t'i nënshtrohet procedurave të përcaktuara në këtë nen 8.

### **KAPITULLI III**

#### **ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME, ADMINISTRATORËT DHE EKSPERTI KONTABËL**

##### **Neni 9 – Asambleja e Përgjithshme dhe kompetencat e saj**

- 9.1 Organi më i lartë vendim-marrës i Shoqërisë është Asambleja e Përgjithshme.
- 9.2 Asambleja e Përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për çështjet vijuese:
- a) ndryshime ose shtesa të Statutit të Shoqërisë;
  - b) emërimin, shpërblimin, zëvendësimin dhe shkarkimin e administratorëve, ekspertëve kontabël dhe likuidatorëve;
  - c) rritjen dhe zvogëlimin e kapitalit themeltar;
  - d) miratimin e transferimit të kuotave;
  - e) vendosjen e ndonjë barre mbi ndonjë kuotë;
  - f) çdo vendim për të miratuar ose shpërndarë një dividend, ose çdo shlyerje kuote, ndarje kuote ose dividendi të ortakëve;
  - g) shpërblimin e administratorit të Shoqërisë;
  - h) zbatimin e çdo vendimi që miraton çdo marrëveshje huaje dhe garanci mbi vlerën që përfaqëson 60% (gjashtëdhjetë për qind) të kapitalit themeltar të Shoqërisë, siç do të jetë herë pas here;
  - i) ndryshimin në lidhje me të drejtat nënshkruese për detyrimet e Shoqërisë;

- j) të drejtën për të transferuar të gjitha ose një pjesë të konsiderueshme të aseteve të Shoqërisë me një vlerë kontabile që tejkalon 5% (pesë për qind) të totalit të aktiveve të Shoqërisë;
- k) çdo vendim për të krijuar, blerë, shitur ose zotëruar ndonjë shoqëri të kontrolluar nga Shoqëria;
- l) miratimin e çdo vendimi që përbën një ndryshim thelbësor në natyrën e biznesit të Shoqërisë;
- m) çdo vendim për të transformuar, bashkuar, shkrirë, ndarë, prishur, ose likuiduar Shoqërinë ose për ta riorganizuar atë në një formë tjetër;
- n) miratimin e pasqyrave financiare vjetore;
- o) krijimin e shoqërive, regjistrimin dhe blerjen e kuotave / aksioneve në kapitalin e shoqërive të tjera, qoftë në Shqipëri ashtu edhe jashtë saj;
- p) çdo çështje tjetër të përcaktuar nga legjislacioni në fuqi, Statuti dhe marrëveshjet e ortakëve (nëse ka ndonjë).

#### **Neni 10 – E drejta e pjesëmarrjes dhe e votës**

- 10.1 Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në Asamble e Përgjithshme, të paraqesë mendimin e tij dhe të japë aq vota sa është kuota që ai zotëron në kapitalin themeltar të Shoqërisë.
- 10.2 Çdo ortak ka të drejtë të përfaqësohet nga një person tjetër i pajisur me prokurë me shkrim, i cili jo domosdoshmërisht duhet të jetë ortak. Në çdo rast, prokura me shkrim do të jetë e vlefshme për një Asamble të Përgjithshme, si për thirrjen e parë ashtu edhe për thirrjen e dytë të saj.

#### **Neni 11 – Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme, kuorumi dhe vendimet**

- 11.1 Asambleja e Përgjithshme thirret të paktën një herë në vit, brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit financiar për miratimin e inventarit dhe bilancit, të raportit të Administratori/ët, si dhe raportit të ekspertit kontabël (nëse është emëruar). Për më tepër, Asambleja e Përgjithshme do të mbledhet në çdo kohë kur kërkohet nga legjislacioni në fuqi ose nga Statuti i Shoqërisë dhe çdo herë që kjo mbledhje është e nevojshme për të mbrojtur interesat e Shoqërisë.
- 11.2 Asambleja Përgjithshmethirret nga Administratori/ët ose prej ortakëve që përfaqësojnë të paktën 5% (pesë për qind) të kapitalit themeltar. Asambleja Përgjithshme duhet të thirret nëpërmjet njoftimit me letër rekomande që duhet t'u dërgohet ortakëve në adresën që ata i kanë njoftuar Shoqërisë si edhe ekspertit kontabël (nëse është emëruar), të paktën 7 (shtatë) ditë përpara mbledhjes së Asamblesë. Thirrja duhet të përmbajë informacion mbi llojin e Asamblesë Përgjithshme, çështjet që do të trajtohen dhe për të cilat do të merret vendim, vendin, orën dhe datën e thirrjes së parë dhe të dytë.
- 11.3 Asambleja Përgjithshme mund të thirret edhe jashtë selisë së Shoqërisë, në Shqipëri apo jashtë saj.
- 11.4 Asambleja e Përgjithshme mund të mbahet edhe nëpërmjet telekonferencës dhe videokonferencës, me kusht që të gjithë pjesëmarrësit të mund të identifikohen nga kryetari dhe t'u lejojat atyre të ndjekin diskutimin dhe të marrin pjesë aktivisht në të; pasi të jenë verifikuar këto kërkesa që duhet të rezultojnë në procesverbalin e mbledhjes, Asambleja e Përgjithshme konsiderohet e mbajtur në vendin ku ndodhet njëkohësisht Kryetari dhe Sekretari i mbledhjes.
- 11.5 Asambleja e Përgjithshme do të thirret dhe mbahet rregullisht edhe pa respektimin e formaliteteve të njoftimit, në rast se janë të pranishëm ortakët që përfaqësojnë të tërë kapitalin themeltar, dhe nëse ata janë dakord të marrin vendime pavarësisht parregullsisë së

njoftimit.

- 11.6 Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme, për të cilat është e nevojshme një shumicë e zakonshme, janë të vlefshme nëse janë të pranishëm ortakët që zotërojnë më shumë se 30% (tridhjetë përqind) të kapitalit themeltar. Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme, për të cilat është e nevojshme një shumicë e cilësuar, janë të vlefshme nëse janë të pranishëm ortakët që zotërojnë më shumë se 50% (pesëdhjetë përqind) të kapitalit themeltar. Në mungesë të kuorunit, asnjë çështje nuk do të trajtohet në mbledhje, dhe Asambleja e Përgjithshme do të shtyhet edhe për shtatë (7) ditë kalendarike; në vijim të saj, Mbledhja e Përgjithshme do të mbledhet përsëri në të njëjtin vend dhe në të njëjtën mënyrë si për Mbledhjen e Përgjithshme të Ortakëve, fillimisht të planifikuar.
- 11.7 Asambleja e Përgjithshme vendos përcështjet sipas paragrafit (a), (c), (f) dhe (m) të nenit 9.2. më sipër, me votën pro të të paktën 75% (shtatëdhjetë e pesë përqind) të kapitalit të ortakëve pjesëmarrësve. Në të gjitha rastet e tjera dhe kur nuk është përcaktuar ndryshe në Statut, Asambleja e Përgjithshme merr vendim me votën pro të shumicës së kapitalit të ortakëve të pranishëm.
- 11.8 Asambleja e Përgjithshme drejtohet nga Kryetari i caktuar ndërmjet ortakëve ose personave të tjerë të pranishëm. Asambleja e Përgjithshme emëron një Sekretar, i cili mban procesverbalin dhe që mund të jetë edhe jo-ortak.
- 11.9 Vendimet dhe procesverbalet e Asamblesë së Përgjithshme do të mbahen në gjuhën angleze dhe të gjitha dokumentat e materialet e shpërndara për këto mbledhje do të jenë në anglisht ose do të kenë bashkangjitur përkthimin anglisht, të nënshkruara nga Kryetari dhe nga Sekretari i Asamblesë së Përgjithshme.

#### Neni 12 – Administratori/ët

- 12.1 Shoqëria administrohet nga një ose më shumë administratorë, të emëruar nga Asambleja e Përgjithshme për një afat deri në 5 (pesë) vite. Në përfundim të këtij afati, Administratorët mund të rizgjidhen.
- 12.2 Administratorët përfaqësojnë Shoqërinë ndaj palëve të treta dhe kanë të gjitha kompetencat e administrimit të zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të Shoqërisë, përveç kompetencave që në bazë të Statutit ose ligjit i përkasin organeve të tjera të Shoqërisë.
- 12.3 Administratorëve të Shoqërisë do tu jepet e drejta të ushtrojnë kompetenca specifike dhe ata mund të veprojnë bashkërisht ose individualisht, siç përcaktohet në aktin e emërimit ose në Statut.
- 12.4 Shoqëria mund, vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, të sigurojë për përfitimin e Administratorëve, siguracion për të mbuluar përgjegjësitë civile të Administratorëve ndaj palëve të treta gjatë kryerjes së detyrave të tyre dhe/ose për veprimet që ata kryejnë si Administratorë të Shoqërisë.
- 12.5 Pa rënë ndesh me parashikimet e pikës 12.4, Shoqëria mundet gjithashtu, vetëm në bazë të vendimit të Asamblesë së Përgjithshme, të dëmshpërblejë dhe rimbursojë Administratorët për përgjegjësitë civile të Administratorëve ndaj palëve të treta gjatë kryerjes së detyrave të tyre dhe/ose në veprimet që ata kryejnë si Administratorë të Shoqërisë dhe/ose të rimbursojë çdo shpenzim të kryer nga Administratorëve për atë qëllim.
- 12.6 Mbledhjet e Administratorëve të Shoqërisë do të mbahen jo më pak se 4 (katër) herë në vit dhe në intervale jo më shumë se 3 (tre) muaj. Mbledhjet mund të mbahen me praninë personale të tyre apo me video-konferencë, telefon apo e-mail. Çdo mbledhje e

Administratorëve të Shoqërisë do të mbahet në gjuhën angleze dhe çdo material me shkrim i diskutuar do të jetë në anglisht, dhe nëse dokumentet përkatëse janë kërkuar të mbahen në shqip, atëherë duhet të sigurohet përkthimi në anglisht i tyre.

- 12.7. Mbledhjet e Administratorëve të Shoqërisë mund të mbahen në një vend tjetër të ndryshëm nga selia, brenda Republikës së Shqipërisë ose jashtë saj. Mbledhjet mund të mbahen gjithashtu me audio ose video-konferencë, me kusht që të gjithë pjesëmarrësit të identifikohen dhe t'i jepet mundësia për të ndjekur diskutimin dhe të marrin pjesë aktivisht në të; procesverbali i mbledhjes do të nënshkruhet nga të gjithë Administratorët që marrin pjesë në mbledhje.

#### **Neni 13 – Eksperti kontabël i autorizuar**

- 13.1 Në rast se kërkohet nga ligji, kontrolli i bilanceve dhe librave kontabël të Shoqërisë do të kryhet nga eksperti kontabël i emëruar për një periudhë 1 (një) vjeçare me mundësinë për t'u rizgjedhur për një periudhë tjetër nga Asambleja e Përgjithshme.
- 13.2 Eksperti kontabël i autorizuar mund të shkarkohet sipas mënyrës së parashikuar nga legjislacioni në fuqi.

### **KAPITULLI IV VITI FINANCIAR, BILANCI VJETOR, SHPËRNDARJA E FITIMEVE**

#### **Neni 14 – Viti Financiar dhe Bilanci Vjetor**

- 14.1 Viti financiar fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor të secilit vit.
- 14.2 Bilanci vjetor, llogaritë financiare, inventari, raporti i Administratorit dhe ekspertit kontabël të autorizuar (nëse është emëruar) miratohen nga Asambleja e Përgjithshme.
- 14.3 Dokumentat që lidhen me vitin financiar duhet të miratohen brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit financiar.

#### **Neni 15 – Fitimet**

- 15.1 Fitimet që rrjedhin nga bilanci vjetor pas zbritjes së të gjitha shumave që Asambleja e Përgjithshme ka vendosur të lërë mënjanë, u shpërndahen ortakeve në proporcion me kuotën e tyre.
- 15.2 Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë, për qëllime të posaçme, krijimin e rezervave të posaçme apo të jashtëzakonshme, ose mund të vendosë edhe shtyrjen e shpërndarjes së fitimeve, tërësisht apo pjesërisht.

### **KAPITULLI V SHPËRNDARJA DHE LIKUJDIMI**

#### **Neni 16 – Shpërndarja**

- 16.1 Shoqëria mund të shpërndahet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.
- 16.2 Shoqëria nuk shpërndahet në rast të paaftësisë për të vepruar, paaftësisë ligjore, vdekjes, likuidimit apo falimentimit të ortakëve.

#### **Neni 17 – Likuidimi**

- 17.1 Në rast të prishjes, Shoqëria duhet të likuidohet.

- 17.2 Për të administruar këtë procedurë, Asambleja e Përgjithshme emëron një ose disa likuidatorë, të cilët do të paraqesin raportin përfundimtar të likuidimit mbi gjendjen e aktivitetit dhe pasivitetit të Shoqërisë, mbi operacionet e likuidimit dhe mbi kohën e nevojshme për të përfunduar likuidimin.
- 17.3 Me përfundimin e procedurës së likuidimit, Asambleja e Përgjithshme merr vendim lidhur me bilancin përfundimtar, punën e kryer nga likuiduesi/ët dhe përfundimin e procesit të likuidimit.
- 17.4 Pas pagesës së kreditorëve dhe mbledhjes së kredive, likuidatori/ët do t'ia shpërndajnë asetet dhe fitimin që mbetet pas likuidimit ortakëve në proporcion me kuotën e zotëruar prej tyre.

## KAPITULLI VI TË TJERA

### Neni 18 – Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

- 18.1 Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin dhe/ose zbatimin e këtij Statuti, si edhe ato që mund të lindin midis ortakëve ose midis një apo disa ortakëve dhe Shoqërisë, do të zgjidhen në mënyrë miqësore dhe të drejtpërdrejtë ndërmjet palëve të interesuara.
- 18.2 Në rast se nuk arrihet në një zgjidhje miqësore të mosmarrëveshjes, ajo do t'i besohet Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

### Neni 19 – Gjuha

Ky Statut është hartuar në 3 (tre) kopje në gjuhën në gjuhën shqipe.

### Neni 20 – Dispozita të Fundit

Për çdo çështje që nuk rregullohet posaçërisht nga ky Statut, do të zbatohen dispozitat e legjislacionit shqiptar për Shoqëritë Tregtare.

ORTAKU I VETËM

Për: YLMAKO Sh.p.k

SAMIR KRASNIQI  
z. Samir Krasniqi





REPUBLIKA E SHQIPERISE

Notere: Valbona SELIMI

Rruga Hoxha Tahsim, Godina nr.292, Tirane

Mob. 0695761243; email: [valbona.syri@gmail.com](mailto:valbona.syri@gmail.com)

Nr. 1800 Rep.


### VERTETIM NENSHKRIMI

Sot, me daten 24/04/2019, prane zyrave te Tonucci & Partners Albania shpk ne Rr. Abdi Toptani, Torre Drin, kati 2, Tirane, para meje noteres Valbona Selimi, anetare e Dhomes se Notereve Tirane, me zyre noteriale ne Rr. Hoxha Tahsim, Godina nr.292, kati i I-re, Tirane, u paraqit personalisht:

1. **Samir Krasniqi**, shtetas kosovar, i datelindjes 06/02/1972, ne Pomozotin, Republika e Kosoves, me zotesi te plote juridike per te vepruar, i identifikuar me leternjoftimin Nr.ID0283167 e nr.personal 2014313977, ne cilesine e perfaqesuesit te shoqerise YMALKO shpk, me nr.biznesi 810031451.

i cili nenshkroi aktin e themelimit dhe statutin e shoqerise YMALKO Albania shpk, bashkelidhur ketij vertetimi.

Ky vertetim leshohet nga une noterja ne baze te ligjit 'Per noterine' dhe udhezimit nr.7203 date 16.09.2009, pika 2 te Ministrit te Drejtesise.

  
VALBONA SELIMI/NOTERE

